



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:179291

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06037697

KPPP.nr.230/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.SH.T.P. “Metaltehnika Asllani” me numër të regjistrimit të biznesit 80327765, me seli në Bresje Fushë Kosovë, kundër debitorit “Delta – Ing” SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 80031092 dhe numër unik identifikues 81044464, me seli në Prishtinë, Veternik Magjistranja Prishtinë – Ferizaj km2, përfaqësuar nga E.S., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.73/20 të datës 24.01.2020, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 09.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Delta – Ing” SH.P.K., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.73/20 i lejuar me datë 24.01.2020, nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P.SH.T.P. “Metaltehnika Asllani” ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.73/20 të datës 24.01.2020 me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës Nr.20703 të datës 02.07.2019, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 1,769.00€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm përmes bllokimit të xhirollogarive bankare dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor me arsyetimin se kreditori në procedurë përmbartimore është duke kërkuar kryerjen e pagesës në lartësi prej 1,769.00€ pa dërguar fare mall. Ka shtuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi nuk është e përshtatshme për përmbartim, pasi që e njëjta duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe njëkohësisht t'i bashkëngjitet fletë dërgesa e mallit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit si dhe të shfuqizoj urdhrin përmbartimor P.nr.73/20 të datës 24.01.2020.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara, duke shtuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi është dokument i përshtatshëm për përmbartim, pasi që e njëjta është pranuar nga debitori çka vërtetohet edhe përmes nënshkrimit. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pathemeltë dhe urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: "*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: "*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*".

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbartimor P.nr.73/20i datës 24.01.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, në dokument të besueshëm, Faturën Nr.20703 të datës 02.07.2019, e cila faturë i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është

emërtuar malli i cili ka qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është bashkangjitur në shkresat e lëndës në formë origjinale.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit në lidhje me mos pranimin e mallit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, andaj në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.230/24, datë 09.08.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.